



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:026342

Datë: 05.12.2024

Numri i dokumentit: 06551013

Në çështjen juridike të :

AC-I-24-0756-A0001

Paditësi

O Th me përfaqësues sipas autorizimit, avokatin B I, Prishtinë

Kundër:

E paditura/Ankuese

N.SH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Asllan Krasniqi, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2766, të datës 3 shtator 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 5 dhjetor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
- Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2766, i datës 3 shtator 2024.
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 14 korrik 2014, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0243 të datës 26 mars 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensimin e 3 pagave të fundit të papaguara në shumën prej 1,513.07 euro për periudhën janar-mars 2006, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit.

Në ankesë ishte theksuar se paditësi në rastin konkret kishte vepruar sipas ligjit dhe udhëzimeve të AKM-së pra ka marrë letrën zyrtare nga AKM për ndërprerje të marrëdhënies së punës me të cilën është udhëzuar se ai do të kontaktohej kur të fillojnë procedurat e likuidimit. Paditësi ishte në marrëdhënie pune me N.SH dhe në aspektin ekonomik ishte i varur nga kjo punë dhe kishte punuar 20.74 vjet. Ky borxh i N.SH-së ndaj tij nuk ishte mohuar as nga vetë N.SH-ja dhe as nuk mund të mohohet sepse Ligji i AKP-së e parasheh një gjë të tillë. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesën e paditësit për tri paga të fundit të papaguara në shumën e përcaktuar me interes 10%.

Ankesës i kishte bashkëngjitur: autorizimin për përfaqësim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0243 të datës 26 mars 2014, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006 si dhe listën përfundimtare të përfituesve të 20%.

Me datë 27 janar 2017, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën ishte theksuar se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshëm ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Pala kundërshtare kishte theksuar se natyra e lëndës është përsëritëse, pra ka një jurisprudencë të konfirmuar disa herë të DHPGJS-së. Në rastin konkret parashtruesi nuk rezulton të ketë ndërprerë këtë afat të parashkrimit brenda tre viteve nga janar 2006 si periudha e vetme e lejuar para se të parashkruhej pretendimi në fjalë. Pala kundërshtare kishte theksuar se njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës lidhet vetëm dhe ekskluzivisht me përpilimin e të ashtuquajturës “Lista e 20%”. Njoftimi në fjale në asnjë moment nuk udhëzon dhe aq më pak ndalon parashtruesin që të drejtat e tij për tre paga të papaguara t’i mbroj dhe si rezultat përmes gjykatës siç kanë bërë mijëra punëtorë të tjerë të N.SH-ve para se këto kërkesa të parashkruhen. Së fundi qëndrimi i të paditurës është se afati i parashkrimit nuk i lejon Autoritetit të Likuidimit dhe/ose DHPGJS-së të analizoj dhe shqyrtojnë meritat e rastit. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e

Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur kërkesën për emërimin e anëtarëve në Autoritetin e Likuidimit.

Me datë 10 shkurt 2017, paditësi kishte paraqitur përgjigje në mbrojtje në të cilën kishte përsëritur pretendimet si në ankesë dhe i kishte propozuar gjykatës që të miratoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Me datë 21 shkurt 2017, AKP-ja kishte paraqitur kundërpërgjigje në përgjigjen e paditësit në të cilën i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AL-së.

Me datë 17 korrik 2024, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin nga i cili kishte kërkuar që të dorëzoj në gjykatë librezën e punës, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, listën e pagave me të cilën dëshmohet se i njëjti ka pranuar pagë nga N.SH dhe prova tjera në mbështetje të pretendimeve ankimore.

Me datë 29 korrik 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e lartcekur dhe në gjykatë kishte dorëzuar këto prova: kopjen e librezës së punës së paditësit, listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj si dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006.

Me datë 3 shtator 2024, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-2766 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit dhe kishte ndryshuar vendimin e AL-së me nr. PRN046-0243 të datës 26 mars 2014, ashtu që kishte obliguar të paditurën që në emër të kompensimit të tre pagave të papaguara t'i paguaj paditësit shumën prej 1,513.07 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 10% shumën prej 151.30 euro. Gjithashtu, obligohet e paditura që t'i paguaj shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 124.00 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se gjykata kishte ardhur në përfundim se ankuesi kishte ofruar shërbime pune për N.SH dhe N.SH i kishte mbetur borxh pagat dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara në shumën e aprovuar si në dispozitiv. Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1,513.07 euro gjykata ishte bazuar në listë pagesën e pagave të datës 31 mars 2006, të cilat janë të nënshkruara nga drejtori financiar Sh M si dhe drejtori N L, e të njëjtat poashtu e mbajnë edhe logon e N.SH-së. Gjukata kishte vlerësuar edhe pretendimet tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Me dat 30 shtator 2024, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-2766 të datës 3 shtator 2024 (aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë se ekzistojnë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit e ka për obligim t'i pranoj dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me "Afatin për parashtrimin e kërkesave" që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit dhe afati i dytë që ka të bëj me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Dy afatet e lartcekura janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë të kërkesa e tij të pranohet. Andaj, Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj ex officio. Andaj, Kolegjit të Apelit i kishte propozuar si më lartë. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0243 të datës 26 mars 2014.

Me datë 6 nëntor 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën i propozon Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të refuzohet si e pabazuar ankesa e AKP-së, ndërsa të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e 3 pagave të fundit të papaguara në shumën prej 1,513.07 euro për periudhën janar-mars 2006, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur provat si në vijim: kopjen e librezës së punës së paditësit, listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj si dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim të tre pagave të papaguara në shumën prej 1,513.07 euro me arsyetimin se paditësi kishte dorëzuar prova relevante që dëshmojnë se të njëjtit i takon kompensimi në fjalë.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga lista e llogaritjes së tri pagave të fundit të papaguara për paditësin shihet qartë se N.SH i kishte mbetur të njëjtit borxh tre pagat e fundit të papaguara në shumën prej 1,513.07 euro.

Gjithashtu përmes kopjes së librezës së punës dhe njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006, vërtetohet se paditësi kishte ofruar shërbime pune për N.SH deri në ditën e privatizimit të saj dhe atë me 24 mars 2006, ditë kjo kur i ishte mbyllur edhe librezja e punës.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësit nuk i takon kompensimi në shumën dhe për periudhën e pretenduar.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim të tri pagave të fundit të papaguara për periudhën janar-mars 2006 në shumën prej 1,513.07 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 11 tetor 2024, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 5 dhjetor 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
